

## SHERBIMI I EMERGJENCAVE CIVILE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

### **1. Pak histori për zhvillimet e Mbrojtjes Civile në Shqipëri.**

Fusha e Mbrojtjes Civile në Shqipëri është relativisht e re dhe në të shkuarën kryesisht ka shërbyer si një strukturë ushtarake. Megjithëse edhe më herët ka pasur problematikë dhe sigurisht njerëz që merreshin me mbrojtjen civile, por e mbështetur mbi baza ligjore, ky shërbim për herë të parë është formalizuar me dekret të Kuvendit Popullor Nr. 3924, dt. 07.12.1964, i cili e vendoste Shërbimin e Mbrojtjes Civile, në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Më vonë, drejtimi në nivel qendror i këtij shërbimi kaloi në Këshillin e Ministrave e më pas në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe sot në Ministrinë e Brendshme.

### **2. Zhvillimet e viteve të fundit.**

Në vitet e fundit, Mbrojtja Civile në Shqipëri është rinovuar në koncept, strukturë dhe detyra, duke u përafëruar me strukturat e vendeve të tjera në funksion të planifikimit, koordinimit dhe menaxhimit sa më të mirë të emergjencave civile.

Kriza e vitit 1998-1999, gjatë kohës së luftës në Kosovë shërbeu si një shembull i mirë, ku u ndërthurën shumë faktorë, duke përfshirë planifikimin e emergjencave, mbrojtjen civile dhe menaxhimin e krizës.

Siguria e qytetarëve, e pronës, e mjedisit dhe e vlerave kulturore merr rëndësi të veçantë edhe për shkak të kërcënimeve të rreziqeve, që janë rezultat i prodhimit, përdorimit dhe ruajtjes së materialeve të rrezikshme, si dhe aktiviteteve kriminale e terroriste, që mund të kërcënojnë jetën e komunitetit.

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1, 170 dhe 174 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat Civile". Ky është ligji i parë në historinë e legjislacionit shqiptar, i përmbledhur dhe i pavarur në këtë fushë. Gjatë viteve të fundit janë bërë përparime në kompletimin e bazës ligjore, planifikimit në të gjitha nivelet, ngritjes së strukturave si dhe ngritjes tekniko-profesionale të personelit të Shërbimit të Emergjencave.

### **3. Strukturat drejtuese dhe planizuese aktuale.**

Planifikimi dhe përballimi i emergjencave civile (në radhë të parë) është detyrë e Shtetit Shqiptar që synon:

- Parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.

- Garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile krijohen struktura të përhershme dhe të përkohshme në nivel qendror dhe vendor.

Strukturat e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Nivel Kombëtar janë paraqitur në skemën nr. 1. (**Shiko Skemën nr. 1**)

### **Struktura Qendrore.**

*a. Këshilli i Ministrave*, është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në Republikën e Shqipërisë. Detyra kryesore e tij është miratimi i politikave dhe programeve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile, miratimi i planit kombëtar të emergjencave, marrja e vendimeve të rëndësishme për përballimin e emergjencave civile dhe krijimi i kushteve për forcimin e strukturave dhe trajnimin e personelit të emergjencave civile.

*b. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile* është një strukturë e përkohshme dhe krijohet kur shpallet gjendja e emergjencës civile. Ky komitet bashkërendon veprimet e strukturave të shërbimit të emergjencave, menaxhimin dhe përdorimin e rezervave shtetërore, vlerëson dëmet e shkaktuara dhe masat për riaftësimin nga fatkeqësitë.

*c. Ministria e Brendshme* është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar të emergjencave civile dhe së bashku me institucionet e tjera zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e emergjencave civile.

Kjo Ministri bashkërendon veprimet e të gjitha palëve dhe të organeve të qeverisjes vendore për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre për përballimin e emergjencave civile.

Për përgatitjen dhe zbatimin e detyrave të saj në Ministrinë e Brendshme, në bazë të urdhrit të Kryeministrit Nr. 71, datë 19.04.2006 funksionon *Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile*.

*d. Ministritë e linjës* janë përgjegjëse për organizimin, planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në veprimtarinë që kanë në përgjegjësi, duke hartuar plane si dhe marrë masa parandaluese.

### **4. Strukturat Lokale**

Struktura lokale e planifikimit dhe e përballimit të emergjencave civile përbëhet nga strukturat në nivel qarku, bashkie dhe komune.

*Prefekti është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në qark, duke bashkërenduar punën për hartimin e planeve, zbatimin e masave mbrojtëse dhe përballimin e emergjencave civile. Si pjesë e strukturës së administratës së Prefektit është Specialisti i Emergjencave Civile dhe inspektorët e emergjencave në rrethe. Në situata emergjente në nivel qarku funksionon Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile anëtarë të të cilit janë drejtuesit e strukturave lokale.*

Në çdo bashki dhe komunë krijohet *Komisioni Vendor për Emergjenat Civile* për të bashkërenduar përpjekjet dhe forcat për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile **(Shiko Skemën nr. 2)**

## **5. Strukturat Operacionale të Emergjencave Civile**

Strukturat operacionale të Shërbimit të Emergjencave Civile, në nivel qendror dhe vendor, funksionojnë përmes 2 grupesh të strukturave bazë operacionale.

- a. Strukturat vepruese aktive
- b. Strukturat vepruese mbështetëse

Për organizimin e strukturave Operacionale të Shërbimit të Emergjencave Civile në nivel kombëtar, rajonal e lokal, **(Shiko skemën nr. 3)**

Organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile janë përshkruar në VKM Nr. 531 dt. 01.08.2003. Strukturat operacionale më të rëndësishme të këtij shërbimi janë PMNZSH, Policia e Shtetit dhe policitë e tjera, Baza e Mbrojtjes Civile (BMC) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, detyrat e të cilave trajtohen shkurtimisht veças në këtë faqe.

### **I. Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit, (PMNZSH)**

Një hap i rëndësishëm gjithashtu është bërë dhe në fushën e mbrojtjes nga zjarri me aprovimin e ligjit Nr. 8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin", misioni i të cilës është mbrojtja e jetës së njerëzve dhe e pronës nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive të tjera në raste të emergjencave. MNZSH është detyrë e organeve shtetërore, ministrive dhe institucioneve qendrore, organeve të qeverisjes vendore, organeve të specializuara dhe e personave juridikë, fizikë vendas dhe të huaj që kryejnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

*Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit, (PMNZSH), është pjesë përbërëse e forcave operacionale në gatishmëri të përhershme me qëllim parandalimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve dhe të pronës nga rreziku i zjarrit, kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, dhënies së asistencës teknike, si dhe për ndërhyrjen në rastet e emergjencave.*

### **II. Policia e Shtetit dhe policitë e tjera**

Marrin pjesë në operacionet e shpëtimit veçanërisht me forcat speciale, bëjnë mbrojtjen dhe sigurimin e zonës, rregullimin e trafikut, ruajtjen e rendit publik, vlerësimin e dëmeve veçanërisht në njerëz.

### **Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit (DPRSH)**

DPRSH funksionon si strukturë në Ministrinë e Brendshme dhe ka degët e saj në disa rrethe. Kjo drejtori funksionon si strukture aktive mbështetëse dhe ka si mision krijimin dhe menaxhimin e rezervave të shtetit, fokusuar kryesisht në rezervat për emergjencat civile.

### **7. Buxheti**

Buxheti i Ministrisë së Brendshme dhe i institucioneve të tjera si zë më vete për Emergjencat Civile është burimi parësor financiar, për përballimin e emergjencave civile.

Burime të tjera financiare mund të jenë fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, të ardhurat e pushtetit vendor, të ardhurat e krijuara nga shërbimi për të tretët, të cilat kalojnë tërësisht në buxhetin e tyre si dhe nga donatorë të ndryshëm.

### **8. Sfidat dhe drejtimit e punës për të ardhmen.**

Shërbimi i Emergjencave Civile në Republikën e Shqipërisë, përballet me shumë sfida, që në esencë kanë të bëjnë me ngritjen e një sistemi funksional, i cili të përmbushë synimet kryesore, që janë siguria e jetës, pronës dhe ambientit të kërcënuar nga emergjencat civile.

Zhvillimi i politikës në fushën e emergjencave civile, mbështetet në drejtimit që rrjedhin nga MSA-ja dhe konsiston në:


- Përmirësimin dhe përafrimin me standartet evropiane të Shërbimit të Emergjencave Civile.
- Zhvillimin e qëndrueshëm, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional, brenda dhe jashtë vendit.
- Përmirësimi i indikatorëve që influencojnë në rritjen e sigurisë së qytetarëve, pronës së tyre dhe ambientit.

Disa nga drejtimit kryesore të punës së Shërbimit të Emergjencave Civile janë:

- Përshtatja e Shërbimit të Emergjencave Civile me standartet evropiane (neni 107 i MSA), si dhe në përputhje me programin dhe direktivat e Komunitetit Evropian.
- Zbatimi i politikave nxitëse për mbrojtjen e popullatës, pronës, dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
- Përmirësimet strukturore si dhe rritja e nivelit profesional të personelit të Shërbimit të Emergjencave Civile.

- Menaxhimi i sistemit të informacionit dhe komunikimit të emergjencave civile, informimi dhe lajmërimi i popullsisë për rrezikun si dhe ndodhjen e një emergjence civile.
- Intensifikimin dhe kontrollin e masave parandaluese për emergjencat civile.


Skema 1



Shpjegues:

1. Vartesi direkte →
2. Bashkepunim - - - →
3. Struktura e perhershme □
4. Struktura e perkohshme ○

Skema 2



**DREJTIMI DHE STRUKTURAT OPERACIONALE TE SHERBIMIT TE EMERGJENCAVE CIVILE NE NIVEL KOMBETAR, RAJONAL E LOKAL.**

